

Forumi i pestë rajonal mbi drejtësinë tranzicionale në vendet e ish Jugosllavisë

Përmbledhja e punëtorive

Struktura e KOMRA-s

Igballe Rogova: ... Në vitin 2006 janë mbledh 3 organizata që kanë besuar në drejtësinë tranzicionale, e këto janë: Fondi për të Drejtën Humanitare nga Beogradi, është Dokumenta nga Zagrebi dhe Qendra Hulumtuese nga Sarajeva, do të thotë që janë hulumtuese-dokumentuese.

Sot janë mbi 86 organizata që kanë ardhur këtu në këtë forum dhe quhet Forumi rajonal. Mirëpo, një pjesë e rajonit, një pjesë që flet shqip - nuk e ka ndi veten këtu të barabartë në këtë forum.

Isha e provokuar nga filmi dhe i kam disa fakte që dua me i përmend, se këto gabime nuk guxojnë me ndodh. Ne të gjithë duhet të jemi të barabartë në forum, të barabartë kemi thënë edhe në statut, mirëpo nuk e kemi ndi veten të barabartë.

Ja shembujt konkret. Së pari, materialet kanë qenë jashtëzakonisht dobët të përkthyer shqip. Edhe unë që e flas serbishten, nuk kam mund të kontribuojë, nëse e lexoj statutin në serbisht por edhe nga shqipja nuk kam mund të kontribuoj sepse ka pasur shumë gabime.

Dy. Nëpër punëtori s'kanë mund të kontribuojnë shqiptarët, sepse nuk ka pasur përkthim të mjaftueshëm dhe s'kanë mund të jenë të involvuar 100%.

Tre. Filmin që e keni shfaqur mbrëmë, s'ka qenë në përkthim shqip, por me titra anglisht dhe pastaj pas filmit që është bërë debati, nuk ka pasur përkthim shqip.

Atëherë, për çka jemi mbledh ne këtu? Ne jemi mbledh që t'i dëgjojmë dhe t'i përkrahim familjet që i kanë të zhdukurit dhe akoma nuk dinë ku janë dhe nëse ne nuk lejojmë që ata të jenë të involvuar 100%, unë mendoj se këtu nuk e kemi vendin.

Dhe, ky filmi sot, filmi ishte serbisht i përkthyer, kur fliste dikush shqip ishte në serbisht i titruar, por është dashtë ose përmes dëgjueseve të jetë i përkthyer shqip ose të jetë i titruar shqip.

Dhe së fundi. Në emër të grupit nga Kosova dua të them diçka. Dje, kryetar i Kuvendit, zoti Krivokapiq e patë një fjalim shumë përkrahës për koalicionin dhe gjithë procesin. Por, zonja dhe zotërinj, ai bëri një gaf shumë të madh. Ai tha se “më nuk ka nevojë që të quhet kjo ish-Jugosllavi”, por tha “jemi sllavë të jugut”. Ose, në serbisht, e kam shënuar çka ka thënë: “ne moramo više reći bivša Jugosllavija, nego mi smo južni sloveni”.

Me këtë, zoti Krivokapiq, e fshiu një pjesë të këtij rajoni, që janë shqiptarët. Dhe desha ta kujtoj zotin Krivokapiq se janë 40.000 shqiptarë në Mal të Zi, se janë 40.000 shqiptarë në Maqedoni, se janë 20.000 shqiptarë në Medvegje, Preshevë dhe Bujanovc dhe janë 2 milionë shqiptarë në Kosovë. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Unë do ta prezantoj krejt shkurtimisht punën në punëtorinë numër 2, që e kemi mbajtur dje pas dite dhe e kemi moderuar me kolegun, zotëriun Aleksandar Trifunović. Tema në këtë punëtori ka qenë – Struktura e KOMRA-s dhe kriteret për emërimin e anëtarëve të KOMRA-s.

Vetëm dua të ju tregoj se në këtë punëtori ka pas pak pjesëmarrës dhe gjithsej kanë marrë pjesë 25. Mirëpo, ndoshta edhe kjo ka ndikuar që debati të jetë shumë kualitativ, të ketë ide dhe se më vonë e kam marrë vesh se në disa punëtori tjera ka pas tone më të larta, ndërsa te ne jo. Do me thënë, të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë shumë konstruktivë.

Pyetjet që janë shtruar në këtë punëtori, do të thotë, si e thash në fillim, kanë pas të bëjnë me strukturën dhe me kriteret për emërimin e anëtarëve.

Do të thotë, një ndër pyetjet në temën që është hapur, ka qenë: A duhet KOMRA të jetë e organizuar në mënyrë të tillë dhe të ketë në çdo vend zyre, të ketë një zyre qendrore. Në këtë pyetje, shumica e pjesëmarrësve në debat janë pajtuar që gjithsesi, në secilin vend në rajon të ketë zyre të KOMRA-s dhe prapë po them shumica janë pajtuar që të jetë një zyre qendrore e cila do të bashkëpunonte me zyre rajonale.

Do të thotë, në këtë pyetje, pothuaj të gjithë jemi dakorduar.

Pyetja tjetër ka qenë se, nëse në rast se ideja e tillë është që të ketë zyre rajonale dhe zyre qendrore, atëherë ku do të ishte më së miri të vendoset zyra qendrore. Nuk ka pas shumë propozime për këtë çështje. Në fakt, disa pjesëmarrës në debat kanë cekur se nuk është fare me rëndësi se ku do të jetë zyra qendrore nëse do të organizohet puna mirë në mes zyrave rajonale dhe qendrore. Mirëpo, ka pasur edhe propozime konkrete. Një ndër to ka qenë që, për shkak se në Bosnje e Hercegovinë ka pasur më së shumti viktimë, atëherë zyra qendrore të jetë në Bosnje e Hercegovinë.

Kemi pasur edhe një propozim tjetër interesant që në fakt, për shkak të marrëdhënieve brenda ndërmjet shteteve të ish-Jugosllavisë, zyra kryesore të jetë diku jashtë territoreve të këtyre shteteve. Do të thotë, edhe kjo ka qenë si ide.

Pyetja tjetër ka qenë ku do të duhej të jenë të vendosura zyrat nëpër vende, këto zyrat nacionale. Në fakt, shumica e pjesëmarrësve janë pajtuar që, sikur thash në fillim, në secilin vend duhet të ekzistojë zyra nacionale. Propozimi, është i përkrahur ndër gati shumica e pjesëmarrësve, ka qenë që ato zyre të vendosen në ato vende ku ka pasur më së shumti viktimë, në mënyrë që zyra e Komisionit fizikisht të jetë më afër me dëshmitarët, me viktimat e kështu me radhë.

Ka qenë një propozim që brenda një shteti të ketë më shumë zyre nacionale.

Një ndër temat që kemi prek ka qenë edhe se si është dashur të sigurohet që qeveritë të mos kenë ndikim në Komisionin rajonal – në KOMRA-n. Një ndër pjesëmarrësit e ka cekë, se vetë qasja rajonale garanton se qeveritë nuk do të kenë shumë ndikim në Komision, sepse është rajonal, nuk është nacional. Do të thotë, me këtë edhe janë pajtuar shumica e pjesëmarrësve.

Sigurisht se ide ka qenë edhe çështja se për krijimin e Komisionit rajonal duhet të vendosin kuvendet përkatëse e jo qeveritë, do të thotë secili. Megjithatë, një ndër

pjesëmarrësit ka cek se megjithatë kuvendet e shteteve në rajon janë shumë nacionale, nuk janë një nacionale dhe qeveritë nuk mund edhe të ndikojnë në kuvendet ose parlamentet. Nuk kemi biseduar, edhe pse është përmendur por askush nuk ka pas ndonjë ide për numrin e anëtarëve të KOMRA-s. Do të thotë nuk ka pas asnjë ide për numrin e saktë dhe sa njerëz duhet t'i ketë. Mirëpo, është debatuar për çështjen se a duhet pasur brenda KOMRA-s edhe anëtarë të KOMRA-s a nga ndër kombëtarët apo jo. Për këtë, ka pas ide të ndryshme: po dhe jo.

Gjatë debatit lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit ka pasur ide të ndryshme. Disa pjesëmarrës kanë cek se duhet të jenë të nivelit nacional, e pastaj ata të delegohen në zyrën kryesore të KOMRA-s. Është përmendur se duhet me pas, dhe sigurisht se janë pajtuar të gjithë që në nivel të shteteve të ketë përfaqësim edhe nga komunitet tjera, jo veç të komunitetit shumicë.

Diçka që është me rëndësi dhe që është përmendur rreth procesit të përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit, ka qenë edhe ideja që ai proces duhet të jetë publik dhe duhet me u përcjell sidomos nga organizatat joqeveritare – shoqëria civile, ose nga organizatat joqeveritare të cilat merren me të drejtat e njeriut. Pa dilemë, të gjithë kanë thënë se anëtarët e Komisionit duhet të jenë persona me moral shumë të lartë, që ta kenë një të kaluar të pastër, që të kenë integritet dhe të jenë të besueshëm nga të gjithë.

Ka pas edhe ide interesante që, pse jo, anëtarë të Komisionit të jenë edhe veteranët e luftës, ata të cilët kanë marrë pjesë në luftë. Mirëpo në atë pikë ka pasur replika të ashpra që në fakt nuk duhet me pas njerëz të tillë.

Faktikisht, kjo është e tëra çka është nxjerrë nga debati jonë në punëtorinë numër 2. Faleminderit!